
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data: _____.____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje kuadër

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

22852000-7 Dosje;
44617000-8 Kutë.

Vlera e fondit limit total të marrëveshjes kuadër: 47,298,660 (dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, ose **489,077.24** (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër) Euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përllëgaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve për vitet financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen balance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e balanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nëni 40 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik, për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë në dispozicion minimalisht punonjësit si më poshtë:

Nëse është prodhues i mallit:

- **1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent)** i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.
- **1 (një) ofsetist për makinën e shtypit**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.
- **1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.
- **1 (një) Shofer**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.
- **1 (një) Punëtor shpërndarje**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- Listëpagesa e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, të deklaruara në organet tatimore sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.
- Kontrata pune të vlefshme/ Kontratat e shërbimit të vlefshme, për punonjësit si më sipër. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.
- Për punonjësit me kontratë shërbimi, kontratat duhet të jenë të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

- Diplomë që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi.

Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin “Poligrafi” të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ose

- Librezë punë apo çdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Ose, nëse nuk është prodhues i mallit:

- **1 (një) Shofer**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.
- **1 (një) Punëtor shpërndarje**, i cili mund të jetë në listëpagesën e shoqërisë ose me kontratë shërbimi.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- Listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, të deklaruar në organet tatimore sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.
- Kontrata pune të vlefshme/ Kontratat e shërbimit të vlefshme, për punonjësit si më sipër. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

Shenim: Kriteri nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. P” i ndryshuar; VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve të rishikuar (LKP)”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti,

mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”, bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Kriteri i mësipërm është vendosur për të krijuar një panoramë të përgjithshme lidhur me kapacitetet profesionale që disponojnë operatorët ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar duhet të vërtetojnë se zotërojnë personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, si dhe kompleksitetin e saj, gjykojmë se është shumë e rëndësishme që të sigurohet se këto mallrat objekt prokurimi do të prodhohen sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, dhe të miratuara nga Këshilli Lartë i Arkivit me Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”, si dhe brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Duke qenë se mallrat objekt prokurimi janë mallra që do të prodhohen sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 të Këshillit të Lartë të Arkivit, atëherë kërkesa për 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent), dhe 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit e 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse, kur kemi të bëjmë me ofertues në cilësinë e prodhuesit, është kërkesë e vendosur në kushtet kur kërkohet realizimi i objektit të prokurimit mbi bazën e standarteve të përcaktuara në Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024, si dhe duke patur në konsideratë sasinë e mallit që kërkohet për 46 autoritete kontraktore të shtrirë në të gjithë territorin e vendit, dhe kohën e realizimit sikurse është cituar më sipër. Gjithashtu, në Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 821, datë 26.12.2024, në nenin 10/5/e përcaktohet se: “5. Këshilli i Lartë i Arkivave miraton: e) standardet e kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë; ë) standardet e kutive e të dosjeve për ruajtje të përhershme për dokumentet me RHK, për arkivat e përhershëm, arkivat qendrorë në veprim, si dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre dhe përcakton institucionet dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin”. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, Këshilli i Lartë i Arkivave ka miratuar Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”, sipas shtojcës 1 “Standardet e Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”, bashkëlidhur këtij vendimi; lista e institucioneve që administrojnë dokumente të tipologjisë që janë të detyruara të zbatojnë standartin e kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet nga operatori ekonomik, që disponon kapacitetet teknike e profesionale në lidhje me stafin teknik, për sa kohë që mallrat objekt prokurimi do të duhet të prodhohen ose furnizohen në përputhje me standartet e miratuara, duke treguar kapacitetet e tij në lidhje me personelin. Gjithashtu neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 të ndryshuar, ka përcaktuar se operatorët ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta dhe më tej në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka përcaktuar se ofertat mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së.

Kriteri i mësipërm është në përputhje me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë që mallrat objekt prokurimi janë mallra që do të prodhohen dhe/ose furnizohen në mënyrë të posaçme për autoritetin kontraktor sipas specifikimeve të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit dhe të miratuara nga Këshilli i lartë i Arkivave. Punonjësit e kërkuar janë në përputhje me natyrën e kontratës që do të realizohet dhe mbi të gjitha profilet e tyre janë përzgjedhur ato që janë të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Vendoja e stafit tek in është bërë referuar VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)”.

Grupi-njësi (Profesioni) “Dizenjues grafik dhe në multimedia” Kodi i profesionit: 2166 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Dizenjues grafik dhe në multimedia”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Dizenjuesit grafikë dhe multimedia krijojnë prezantime imazhi apo informacioni për media të ndryshme, përfshi: mediat print, televizion, industri filmike, lojëra kompjuterike, website etj. Përmes njohurive të tyre në fushën e teknologjisë kompjuterike ose artit, ata krijojnë efekte speciale, animime, imazhe të tjera vizuale si dhe prezantime për korporata dhe organizata. Dizenjuesit grafikë dhe multimedia kombinojnë aftësitë kreative me njohjen shumë të mirë të programeve të avancuara kompjuterike për të krijuar produktin që u kërkohet.

Funksionet kryesore

Dizenjuesit grafikë dhe në multimedia kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Përcaktojnë objektivat e produktit duke u konsultuar me pritshmërinë e klientëve;
- b) Studiojnë, analizojnë klientin, organizatën dhe produktet e mëparshme të ngjashme të klientit;
- c) Studiojnë, analizojnë produktet e ngjashme në treg për të krijuar një produkt të diferencuar
- d) Formulojnë konceptet e dizenjimit për produktin që do komunikohet;
- e) Konsultohen për dizenjimin e produktit me analistë biznesi, arkitektë dhe programues softueri;
- f) Përgatitin skica, diagrama dhe modele të ndryshme në print apo kompjuter për të komunikuar konceptet për dizenjimin e produktit;
- g) Dizajnojnë grafikë kompleksë dhe animime për të kënaqur kërkesat funksionale estetike dhe kreative të modelit që do prezantojnë;
- h) Përshtatin skicën apo imazhin dixhital me tekstin apo informacionin që produkti duhet të përcjellë;
- i) Krijojnë imazhe 2 apo 3 D, duke vendosur objektin në lëvizje ose duke ilustruar një proces, duke përdorur programe animimi në kompjuter, print apo modelim;
- j) Sigurojnë nga klienti ose nga ekspertë të kamerës, materiale filmike me cilësi të lartë HD, në rast prodhim video;

- k) Transferojnë dokumente audio, video për t'u edituar në mënyrë dixhitale ose i editojnë vetë duke përdorur programet te posaçme (Adobe Premiere, Final Cut Pro), etj.; l) Krijojnë, apo shkruajnë imazhe dhe grafikë shtesë në video, e shndërrojnë, apo transferojnë videon në formate të ndryshme për web, mobile, dvd, prezantime etj.;
- m) Regjistrojnë zërin audio në rast reklame, dokumentari, etj. dhe përdorin programet përkatëse kompjuterike për pastrimin e zërit;
- n) Montojnë pamjet video, audio duke përdorur efekte muzikore dhe vizuale; o) Krijojnë punë artistike që përdoret në lojëra kompjuterike;
- p) Krijojnë sekuenca të animuara duke përdorur programet softuerë;
- q) Arkivojnë materialet video, audio, apo imazhet dixhitale në një sistem të organizuar dhe ruajtje të të dhënave;
- r) Zgjedhin, specifikojnë apo rekomandojnë materialet funksionale, estetike dhe mediatike për publikim, shpërndarje apo shfaqje skenike;
- s) Detajojnë dhe dokumentojnë produktin e dizajnuar te përzgjedhur për prodhim;
- t) Mbikëqyrin ose ndërmarrin vetë prodhimin e modelit të tij dizajn në mediat e përzgjedhura së bashku me klientin;
- u) Respektojnë kushtet e kontratës për dorëzimin e produktit cilësor dhe në afat;
- v) Respektojnë ligjet në fuqi për të drejtën e autorit;
- w) Rritin profesionalizmin e tyre përmes njohjes së programeve të avancuara kompjuterike, teknikave dizenjuese, e-learning, etj.

Kërkesat për punësim:

a. Arsim i lartë, preferohet në degët: Art, Pikturë, Fotografi, Media, Film, Dizajn etj.;

b. Kualifikime, preferohet njohje ne programet kompjuterike: Adobe Photoshop, Page Maker. Illustrator, In design, Corel Draw. Flash; Adobe Premiere, After Effects 3D design, 3Dmax; Programe web design: Html, CSS, Java Script, J Query etj.;

c. Të jetë kreativ, të ketë sa me shume ide. Informacion shtesë Fusha e dizenjatorit grafik dhe multimedia është shumë e gjerë. Që të jesh i aftë dhe konkurrues në këtë sektor duhen aftësi krijuese të veçanta në kombinim me aftësi teknologjike. Fillimisht për të hyrë në këtë profesion mjaftojnë disa kurse afatshkurtra, për të punuar si montazhier, kameraman, fotograf, teknik audio dhe me pas profesionistet e kësaj fushe mundën që falë kualifikimeve apo dhe rritjes së aftësive të veta te punësohen si dizenjator grafik dhe në multimedia. E veçanta e këtij profesioni është se nuk matet me orë pune. Një video cilësi e lartë 5 minuta mund të kushtojë një muaj punë ose 60 orë punë në jave për ta krijuar. Një dizenjator grafist dhe multimedia mund të punësohet në industrinë filmike, në radio televizion, në gazetë, në shtëpi botuese, në organizata apo departamente PR dhe Marketing, etj, në industrinë e lojërave kompjuterike, në industrinë e programimit web etj. Shpesh këtë profesion në Shqipëri e ushtrojnë edhe si të vetëpunësuar.

Kodi i profesionit: 73 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punonjës të prodhimit të sendeve të imta, punëve me dorë (artizanët), të shtypshkrimit/printimit dhe të tjera të ngjashme”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Punonjësit e prodhimit të sendeve të imta, punëve me dorë (artizanët), të shtypshkrimit dhe të tjera të ngjashme merren me prodhimin dhe riparimin e instrumenteve preçizë, instrumenteve muzikore, artikuj të ndryshëm me metale të çmuara (stoli të ndryshme) artikuj qeramike, qelqe, porcelani, si dhe punime artizanale të drurit, kashte, tekstile, lëkurë apo materiale të tjera të ngjashme. Ata merren me parapërgatitjet, përgatitjen e materialit për botim, faqosjen, bërjen dhe përpunimin e fotove, përgatitjen e shablloneve dhe modeleve të stampimit, lidhjen, presimin, ngjitjen, qepjen, prerjen në makineri në formën e duhur të materialeve për botim. Ata riparojnë dhe tregtojnë

produktet e prodhuara. Ata mund të punësohen në kompani shërbimesh të ndryshme, shtëpi botuese apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore: Punonjës të prodhimit të sendeve të imta, punëve me dorë (artizanët), të shtypshkrimit/printimit dhe të tjera të ngjashme kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Organizojnë punën në njësinë e vetë të shërbimit duke përzgjedhur veglat dhe pajisjet e duhura;
- b) Bëjnë përgatitjen paraprake të vendit të punës (veglat, pajisjet, makineritë, duke kontrolluar funksionimin e rregullt të tyre);
- c) Prodhonjë dhe riparojnë instrumente precizë për kërkime shkencore apo instrumente të tjera;
- d) Riparojnë orë muri dhe dore, pajisje fotografuese, kamera etj.;
- e) Bëjnë, akordojnë dhe riparojnë vegla të ndryshme muzikore;
- f) Kryejnë punime e prodhime argjendarie dhe të metaleve të tjera të çmuara;
- g) Bëjnë bizhuteri të ndryshme dhe artikuj të tjerë artistik;
- h) Kryejnë punime dhe veshje bakri;
- i) Bëjnë dhe riparojnë protezave dentare dhe mjekësore (gjymtyrë artificialë);
- j) Prodhonjë dhe riparojnë enë balte dhe porcelani;
- k) Tornojnë dhe zbukurojnë enë dhe artikuj të tjerë artistikë prej balte dhe porcelani;
- l) Prodhonjë tulla dhe tjegulla;
- m) Punojnë, presin, lustrojnë dhe zbukurojnë qelqin;
- n) Gdhendin, skalitin, ngjyrosin, stampojnë, pikturojnë e dekorojnë qelqin dhe qeramikën;
- o) Dizajnojnë dhe prodhojnë maska të ndryshme;
- p) Kryejnë punime me dorë të artikujve prej druri, kashte, letre, xunkthi e të tjera të ngjashme;
- q) Kryejnë punime me dorë të tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme;
- r) Kryejnë punimin me dorë të leshit dhe pambukut;
- s) Kryejnë endje të pëlhurave, të veshjeve, qilimave, rrjetave të peshkimit etj.;
- t) Kryejnë punime të ndryshme tezgjahu;
- u) Kryejnë proceset përgatitore për shtypshkrime të kartëvizitave, fletëpalosjeve, revistave, librave dhe materiale të tjera të ngjashme;
- v) Përgatitin materialin në kompjuter, bëjnë radhitje të materialit të porositur, faqosjen, përpunim të fotove, grafikëve, tabelave;
- w) Përgatitin shabllone dhe modele të stampimit për tirazhin e duhur;
- x) Kryejnë proceset përfundimtare të një libri, reviste apo botime të tjera periodike; si lidhje, presim, ngjitje, qepje, prerje në makineri në formën e duhur duke e kontrolluar herë pas here punën e bërë;
- y) Bëjnë fotografi dhe kryejnë larje, zhvillim, fiksim filmash bardh e zi ose me ngjyra;
- z) Bëjnë stampim, zmadhim, retushim fotografish etj.;
- a) Mirëmbajnë makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës;
- b) Realizojnë detyrave të ngjashme; cc) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; dd) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit Kërkesat për punësim
- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion.
- b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Grupet e vogla që klasifikohen në këtë Nëngrup të madh janë si në vijim: 731 Punonjës të punimeve me dorë (artizanët) 732 Punonjës të fushës së shtypshkrimit /printimit

Grupi i vogël “Punonjës të fushës së shtypshkrimit /printimit” Kodi i profesionit: 732 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punonjës të fushës së shtypshkrimit /printimit”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Punonjës të fushës së shtypshkrimit/printimit përcaktojnë pajisjen para së të fillojnë printimin, përgatisin dhe vendosin në punë thikat, lidhin dhe përfundojnë produktet e mbaruara, përgatisin shabllonet dhe vendosin në punë pajisjet e printimit.

Funksionet kryesore Punonjës të fushës së shtypshkrimit/printimit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

a) Vënë në përdorim kamera grafike dhe pajisje të tjera fotografike për të riprodhuar kopje të gatshme për t’u fotografuar në filma, letra më lustra dhe në pajisjeje të produkteve dixhitale;

b) Vënë në përdorim pajisje kompjuterike për të mundësuar skanime, ndarjen e ngjyrave dhe korrektime të mundshme;

c) Përgatisin shabllone dhe vënë në përdorim ekranin e pajisjes së printimit;

d) Kryejnë retushimin dhe procese të tjera të përdorura për të transferuar kopje në filma dhe për të prodhuar filma për letër shkëlqyese, cilindra ose prodhime dixhitale;

e) Përgatisin dhe vënë në përdorim makina monitoruese për kopje dixhitale dhe printim;

f) Kryejnë prerje, palosje, bashkim dhe lidhje të materialit të printuar duke përdorur pajisjet dhe makineritë përkatëse;

g) Kryejnë stampime me gdhendje dhe skalitje për kapakët e librave apo për përdorime të tjera;

h) Kryejnë stampime të fotografive dhe rregullime të tjera të tyre;

i) Kryejnë stampime të mëndafshit dhe tekstileve të tjera për përdorime të ndryshme;

j) Kryejnë operacione përfundimtare rutinë të shtypshkrimit;

k) Kryejnë punime mirëmbajtjeje të makinerive.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë fushë;

b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht;

c. Të ketë njohuri në përdorimin e mjeteve të tjera të ngjashme.

Informacion shtesë: Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikimin shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punonjës i fushës së shtypshkrimit-printimit mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e shtypshkrimit-printimit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik ose juridik, sipas rastit. Preferphet të ketë njohuri për mirëmbajtjen e makinerive të shtypshkrimit-printimit.

Profesionet që klasifikohen në këtë grup profesionesh, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë: 7321.01 Radhitës; 7321.02 Teknik i para-shtypit elektronik; 7321.03 Kompozues; 7321.04 Operator publikues; 7321.05 Montues i letrave me shkëlqim (printues ekranesh); 7321.06 Prodhues i letrave (printim); 7321.07 Ndërtues ekranesh ;7321.08 Vendosës në punë i makinerive të ndryshme; 7321.09 Montues lastre; 7321.10 Faqosës shtypshkrimi; 7321.11 Foto radhitës

shtypshkrimesh; 7321.12 Kolaudues në shtypshkronjë; 7321.13 Ofsetist; 7321.14 Radhitës; 7321.15 Radhitës linotipist; 7321.16 Radhitës shtypshkrimesh; 7321.17 Printues i bocave; 7321.18 Parapërgatitës në shtypshkronjë; 7321.19 Përgatitës i pllakave të shtypit; 7321.20 Tipograf; 7321.21 Montues i foljeve; 7321.22 Kaster elektroshtyp; 7321.23 Kaster sterioshtyp; 7321.24 Shtypës elektrik

- **Referuar Urdhërit Nr. 99, datë 25.5.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”, të ndryshuar, në rreshtin nr. 99 të katalogut të këtij urdhëri është përcaktuar:**

Kodi i kualifikimit profesional: **P-II-16;**

Emërtimi i kualifikimeve: **Poligrafi Programe;**

Lloji i kualifikimit profesional: **Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës;**

Profesionet LKP: **Punonjës shtypshkrimi**

Referuar faqes zyrtare Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve është e miratuar SKELET KURRIKULI për Drejtimin Mësimor POLIGRAFI Niveli II i KSHK (2 vjeçar).

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Poligrafi”, niveli II i KSHK. Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Poligrafi” niveli II i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të përdor kompjuterin, printerin, fotokopjen dhe projektorin.
- Të rradhitë në kopjuter tekste të thjeshta, tekste me pjesë dalluese dhe faqosje me programin Word
- Të korrigjojë tekste të rradhitur ose të faqosur.
- Të zbatojë rregullat teknike të rradhimit dhe të ndarjes së fjalëve sipas rregullave drejtshkrimi të gjuhës shqipe
- Të punojë në kopjuter grafika të thjeshta.
- Të kryejë printime dhe stampime në printer dhe fotokopje
- Të punojë si ndihmës në makinat e thjeshta poligrafike
 - Të punojë, me ndihmën e makinistit, për përgatitjen për punë të formës poligrafike dhe veshjes së cilindrit
- Të mirëmbajë makinën poligrafike të shtypit
- Të ngarkojë letrën në aparatin e furnizimit.
 - Të shkarkojë letrën e shtypur në aparatin pritës (dalës)
- Të sistemojë letrën e shtypit
- Të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e shtypit poligrafik.
- Të realizojë montime të thjeshta botimesh, për përgatitjen e formave të shtypit ofset.
- Të eksponojë dhe të zhvillojë (me ndihmën e specialistit) lastra të parandjeshme ofseti
- Të kontrollojë, sistemojë dhe mirëmbajë montazhet e pozitivëve të filmave
- Të pastrojë fletët (foljet) e përdorura për montim.
- Të punojë si ndihmës në makinat e shtypit offset me një dhe shumë bojra.
- Të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e shtypit offset.

- Të mirëmbajë makinën e shtypit offset. - Të lajë dhe të pastrojë aparatet e bojrave, të lagjes dhe të veshjes së gomës (mirëmbajtje teknologjike)
- Të kryejë punime ndihmëse në makina libërlidhëse
- Të kryejë palosje me dorë të fashikujve të shtypur.
- Të kryejë mbledhje me dorë të botimeve të shtypura
- Të presojë blloqe të fashikujve të palosur dhe blloqeve të qepur të librave
- Të kryejë perforimin (birosjen) e botimeve të ndryshme
- Të kryejë paketime me dorë të botimeve
- Të kryejë punime ndihmëse në makinën e paketimit.

5.4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Poligrafi”, niveli II i KSHK. Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Poligrafi”, niveli II i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme poligrafike (shtypshkronja), studiot grafike dhe agjencitë grafike. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III të KSHK në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtijshëm në nivelin IV, nxënësit fitojnë “Maturën shtetërore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

Në përfundim:

Referuar sa më sipërcituar, kërkesa për stafin teknik është e mbështetur sipas legjislacionit në fuqi, por nisur nga verifikimi i institucioneve arsimore të akredituara të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, rezultojnë se asnjë nga këto institucione nuk ka profilin e kërkuar të punonjësve, si dhe në pamundësi për të patur një informacion shterues në lidhje me ofrues të AFP për kualifikimin e kërkuar, sipas përcaktimeve të nenit 4 pika 5 të Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: 5. *“Ofrues i AFP-së” është institucioni publik ose jopublik (person fizik ose juridik), i licencuar dhe/ose i akredituar për të ofruar programe/ shërbime të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.*, si dhe me qëllim zgjerimin e konkurrencës, Njësia e Prokurimit gjykon të arsyeshme që operatorët ekonomik pjesmarrës t’u lihet mundësia që për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse të paraqitjes së dokumentit të kualifikimit konkret siç është përcaktuar në këtë kriter ose të vërtetojë eksperiencën dy vjeçare me librezë punë apo çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të. Afati dy vjeçar i eksperiencës së punës është lënë dy vite, duke marrë parasysh se programi i formimit profesional për këta punonjës është dy vjet.

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikot se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 dhe 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: [...] “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Referuar objektit të prokurimit, kërkohet furnizimi me dosje dhe kuti për ruajtjen e dokumentacionit arkivor, pra kërkohet furnizimi me një produkt i cili do të nënshtrohet procesit të prodhimit sipas specifikimeve teknike pra sipas standarteve të miratuara nga Këshilli i Lartë i Arkivave me Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumentet të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht kërkohet që ofertuesit të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar prej tij. Referuar objektit të procedurës së prokurimit që kërkohet të realizohet gjykojmë se nuk është një kërkesë kufizuese, kriteri që operatorët ekonomikë të disponojnë “autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi sipas standarteve të përcaktuara”. Pra, operatorët ekonomikë kanë detyrimin për të siguruar cilësinë dhe origjinalitetin e produktit që ofrojnë për procedurën objekt-prokurimi, pasi ky nuk është një produkt i gatshëm por një produkt i cili do të nënshtrohet procesit të prodhimit sipas standarteve të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Arkivave. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar vlerësojmë se me anë të kërkesës për paraqitjen e dokumentit të autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nuk kufizohet konkurrenca, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kryerjen e shërbimeve apo furnizimin me mallra për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre. Kriteri i vendosur nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në një procedurë prokurimi si dhe nuk e ul konkurrencën pasi është lënë e hapur mundësia që operatorët ekonomik ofertues mund të sigurojnë mallin jo vetëm në mënyrë direkte nga prodhuesi, por edhe nga distributor të autorizuar nga prodhuesit. Me anë të këtij kriteri është e rëndësishme që të sigurohet që “malli” do të jetë

sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për t'u paraqitur është i parashikuar në kuadrit ligjor të sipërcituar, duke i dhënë mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi (nuk përfshihet etiketa), ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Argumentimi: Në nazë të nenit 77, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikot se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 dhe 6 , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...] “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

Kërkesa për paraqitjen e fletë analizës së lëndës së parë për kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë, që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, është vendosur në mënyrë që të sigurohet që kartoni i përdorur të jetë në përputhje me standartet e miratuara nga Këshilli i Lartë i Arkivave. Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili është prodhimi i dosjeve dhe kutive të kartonit për ruajtjen e dokumentave arkivor, të cilat në zbatimin me Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”, Këshilli i Lartë i Arkivave, ka miratuar standartet e kutive e të dosjeve për ruajtje të përhershme për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, është e rëndësishme që të sigurohet që malli do të jetë sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për t'u

paraqitur është i parashikuar në kuadrin ligjor të sipërcituar, duke i dhënë mundësinë autoritetit kontraktor t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve që ofrojnë me specifikimet teknike.

Specifikimeve teknike janë të miratuara nga Këshilli Lartë i Arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë Pranë tyre”, si organi kompetent i krijuar me ligj dhe akte nënligjore të posaçme dhe si qëllim të tij ka miratimin e standarteve të artikujve objekt prokurimi.

Për këtë arsye, për sa kohë që këto standarte (specifikime teknike) janë të miratuara nga një organ i krijuar me ligj specifik, Njësia e Prokurimit nuk ka tagër të përzgjedhë se cilat prej komponentëve (parametrave) të specifikimeve teknike të artikujve objekt prokurimi, janë më të rëndësishëm ose jo për tu paraqitur nëpërmjet fletë analizës nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Edhe pse Njësia nuk ka tagër të përzgjedhë parametrat, sic u shpjegua me lart, ka kryer verifikimet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, ku rezultoi se asnjë laborator testues në Republikën e Shqipërisë nuk i teston të gjitha parametrat e kërkuara. Laboratori Qëndror i Restuarimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (Laborator i Autoritetit Kontraktor kërkues dhe përfitues i këtij objekti prokurimi) është i vetmi laborator që teston pjesën më të madhe të parametrave të kërkuara në specifikimet teknike, parametra për të cilat është i akredituar, por theksojmë jo për të gjitha parametrat sic kërkohen në Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024.

Në këto kushte, është lejuar që operatorët ekonomikë të paraqesin skedën teknike të prodhuesit ose /dhe fletë analizën për kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, dokumente nëpërmjet të cilave verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara në Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024.

5. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për artikujt e listuara më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti*

ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet konkretisht furnizimi me kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e kutive dhe dosjeve, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Përfshirja e mostrave rrit transparencën dhe objektivitetin, duke i dhënë komisionit të vlerësimit një bazë të qartë për të krahasuar ofertat dhe për të marrë një vendim të drejtë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001** “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- **ISO 14001** “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- **ISO 45001** “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri i mësipërm konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 (një) mjet është vendosur në proporcion me sasinë e mallit që kërkohet, llojin e mallit dhe vendodhjen e 46 Autoriteteve Kontraktore përfitues, ku do të depozitohet malli objekt prokurimi. Vendodhja e 46 Autoriteteve

Kontraktore shtrihet përkatësisht në bashkitë e vendit si: Tiranë, Dibër, Durrës, Gramsh, Fier, Berat, Korçë, Kolonjë, Sarandë, Lezhë, Gjirokastrë etj.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të të gjithë artikujve në adresat e autoriteteve kontraktore të përfshira në këtë procedurë prokurimi të përcaktuar në pikën 2.9 të DT, përgjatë gjithë afatit të marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se mallrat e ofruara janë cilësore dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, duke u bazuar në specifikat e punës që kryen personeli që do t’i përdorë, kushtet e punës, imazhin e autoritetit kontraktor. Në cdo rast operatori ekonomik duhet të mbajë përgjegjësi për mallrat që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik të lëndëve të para e ndihmëse që përdoren.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimeve teknike për artikujt objekt prokurimi janë hartuar dhe miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave si dhe 46 Autoritetet kontraktore përfituese, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe sipas standarteve të miratuara nga Keshilli Lartë i Arkivave me Vendimin Nr. 7, datë 9.9.2024 “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që Ruajnë Dokumentacion Gjithnjë Pranë Tyre”.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

NJËSIA E PROKURIMIT